

# NGRITJA E VETËDIJES PËR DHUNËN KUNDËR GRAVE: NENI 13 I KONVENTËS SË STAMBOLLIT

## Neni 13 – Vetëdijesimi

1. Palët promovojnë ose kryejnë, në baza të rregullta dhe në të gjitha nivelet, fushata ose programe vetëdijesimi, përfshirë bashkëpunimin me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet e barazisë, shoqërinë civile dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, kudo që shihet e përshtatshme, për të rritur vetëdijesimin dhe mirëkuptimin e publikut të gjerë për manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës që bien brenda fushëveprimit të kësaj Konvente, pasojat e tyre mbi fëmijët dhe nevojën për të parandaluar një dhunë të tillë.

2. Palët sigurojnë shpërndarje të gjerë të masave në dispozicion të publiku në përgjithësi për të parandaluar veprimet e dhunës të mbuluara nga fushëveprimi i kësaj Konvente.



PREMS 11/22/14

SHQ

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Këshilli i Evropës është organizatë udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ajo përbëhet nga 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

**Përmbledhje dokumentesh mbi  
Konventën e Këshillit të Evropës  
për parandalimin dhe luftimin  
e dhunës ndaj grave dhe  
dhunës në familje**

**NGRITJA E VETËDIJES PËR DHUNËN  
KUNDËR GRAVE:  
NENI 13 I KONVENTËS SË STAMBOLLIT  
Përmbledhje dokumentesh  
mbi Konventën e Këshillit të Evropës  
për parandalimin dhe luftimin e dhunës  
ndaj grave dhe dhunës në familje**

Karin Heisecke

Këshilli i Evropës

Edicioni francez:

*Sensibilisation à la violence à l'égard des  
femmes:*

*Article 13 de la Convention d'Istanbul*

*Opinionet e shprehura në këtë punim  
janë përgjegjësi e autorit/autorëve dhe  
nuk reflektojnë domosdoshmërisht  
politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.*

Të gjitha kërkesat në lidhje me  
riprodhimin ose përkthimin e gjithë  
këtij dokumenti ose një pjese të tij  
duhet t'i drejtohen Drejtorisë së  
Komunikimit (F-67075 Strasbourg  
Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në  
lidhje me këtë dokument duhet t'i  
adresohen Divizionit për Barazi të  
Drejtorisë së Përgjithshme për  
Demokraci.

Të gjitha URL-të e cituara në këtë  
dokument u vizituan për herë të fundit  
më 4 prill 2014.

Ballina dhe faqosja: SPDP, Këshilli i  
Evropës

© Këshilli i Evropës, shtator 2014  
Shtypur në Këshill të Evropës

# Përmbajtja

---

<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>FUSHËVEPRIMI I NENIT 13</b>	<b>6</b>
<b>ROLI I VETËDIJESIMIT NË PARANDALIM</b>	<b>9</b>
Çfarë dimë për vetëdijesimin dhe parandalimin	10
Përkufizimet	12
<b>DIZAJNIMI DHE ZBATIMI I FUSHATAVE OSE PROGRAMEVE TË VETËDIJESIMIT</b>	<b>13</b>
Fillimi	13
Përzgjedhja e mesazheve dhe audiencës	19
Mjetet dhe mediat për ta përcjellë mesazhin	26
<b>KONKLUKUDIMI</b>	<b>31</b>
<b>LISTA KONTROLLUESE PËR FUSHATAT E VETËDIJESIMIT</b>	<b>32</b>
<b>BURIMET KRYESORE</b>	<b>34</b>
Fushatat dhe iniciativat e vetëdijesimit në Evropë	34
Udhëzime për komunikimin rreth dhunës ndaj grave	36
<b>BIBLIOGRAFIA</b>	<b>37</b>

---



# Hyrje

---

**N**gritja e vetëdijes për format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është element i rëndësishëm në parandalimin e dhunës ndaj grave, sepse vetëdija e rritur është hapi i parë drejt ndryshimeve të qëndrimeve dhe sjelljeve që nxisin ose lejojnë forma të ndryshme të dhunës ndaj grave. Për këtë qëllim, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejshëm "Konventa e Stambollit") kërkon që shtetet palë të ndërmarrin nisma të gjera për vetëdijesim, si pjesë e një sërë masash që synojnë parandalimin e dhunës kundër grave (neni 13). Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një kontekst më të gjerë për parandalim përmes vetëdijesimit dhe këshillave të tjera praktike për politikëbërësit dhe profesionistët për dizajnimin dhe vlerësimin e fushatave të vetëdijesimit. Përshkrime të shkurtra të fushatave të vetëdijesimit të organizuara më parë në vendet anëtare të Këshillit të Evropës shërbejnë si frymëzim dhe janë të përmbledhura në një listë kontrolli për fushatat e vetëdijesimit.

---

<sup>1</sup> Këshilli i Evropës (2011), Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, raport shpjegues, Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg, gjendet në [www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/violence-against-women/Exp\\_memo\\_Conv\\_VAW\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/violence-against-women/Exp_memo_Conv_VAW_en.pdf).

# Fushëveprimi i Nenit 13

**Q**ëllimi i Nenit 13 është të rritet niveli i vetëdijesimit në publikun e gjerë për format e ndryshme të dhunës me të cilat përballen gratë dhe pse është dhunë me baza gjinore. Qëllimi i tij është poashtu që dhuna në familje në të gjitha manifestimet e saj të kuptohet më gjerë nga të gjithë anëtarët e shoqërisë. Kjo nënkupton seduhet të merren masa për të bërë të ditur se ekzistojnë forma të dhunës ndaj grave, si dhuna në familje (dhuna psikologjike, fizike dhe seksuale), përndjekja, dhuna seksuale (përfshirë përdhunimet), martesat e detyruar, gjymtimi i organeve gjenitale të grave, sterilizimi i detyruar, aborti i detyruar dhe ngacmimi seksual, dhe të sygjeroj se çfarë mund të bëjnë individët për ta parandaluar atë apo për t'u ndihmuar grave dhe vajzave në rrezik. Poashtu nënkupton se duhet të hiqet çdo tabu rreth dhunës në familje, se ajo nuk është vetëm çështje private dhe se dhuna në familje prek familjet në të gjitha shtresat e shoqërisë. Natyra gjinore e dhunës në familje si dhunë e burrave ndaj grave në kontekstin e dhunës nga partneri intim duhet të theksohet po aq sa efektet e saj tek fëmijët. Meqenëse është opsionale për shtetet palë që të zbatojnë konventën për të gjitha viktimat e dhunës në familje (abuzimi i fëmijëve, abuzimi i të moshuarve, burrat si viktimat nga dhuna e partnerit intim), i takon secilit shtet anëtar të vendosë për aktivitetet e vetëdijesimit për këto forma të dhunës.

## **Neni 13 - Vetëdijesimi**

(1) Palët promovojnë ose kryejnë, në baza të rregullta dhe në të gjitha nivelet, fushata ose programe vetëdijesimi, përfshirë bashkëpunimin me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe barazisë, shoqërië civile dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, kudo që shihet e përshtatshme, për të rritur vetëdijesimin dhe mirëkuptimin e publikut të gjerë për manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës që bien brenda fushëveprimit të kësaj Konvente, pasojat e tyre mbi fëmijët dhe nevojën për të parandaluar një dhunë të tillë.

(2) Palët duhet të sigurojnë shpërndarje të gjerë të masave në dispozicion të publiku për të parandaluar aktet e dhunës të mbuluara nga fushëveprimi i kësaj Konvente.

Raporti shpjegues i Konventës së Stambollit sqaron më tej natyrën e detyrimeve sipas nenit 13. Në mesin e tyre janë detyrimet kryesore të mëposhtme në lidhje me nismat e ndërjegjësimit të cilat duhet:

- ▶ të ndërmerren rregullisht, duke pranuar se ky duhet të jetë proces i vazhdueshëm dhe afatgjatë e jo një masë e njëhershme;
- ▶ të dizajnohen në mënyrë që të ndihmojnë të gjithë anëtarët e shoqërisë që ta njohin dhunën ndaj grave, të flasin kundër saj dhe të mbështesin viktimat;
- ▶ të adresojnë çështjen në një qasje të ndjeshme gjinore, dhe duke përfshirë informacione mbi barazinë midis grave dhe burrave, role gjinore jo stereotipizuese që thyejnë stereotipet gjinore dhe zgjidhjen pa dhunë të konflikteve;
- ▶ të theksojnë pasojat e dëmshme (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta) për fëmijët;
- ▶ të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe partnerët e tjerë me përvojë relevante (në veçanti me OJQ-të e grave të specializuara në eliminimin e dhunës ndaj grave).

Neni 13, në paragrafin 2, më tutje kërkon nga shtetet palë që të sigurohen se publiku i gjerë është i informuar për masat që janë në dispozicion për të parandaluar aktet e dhunës. Raporti shpjegues sqaron se kjo nënkupton shpërndarjen e gjerë të fletëpalosjeve informuese, posterëve ose materialit informativ në internet për shërbimet e ofruara nga policia, linjat e ndihmëse, strehimoret ose ndonjë shërbim tjetër në nivel nacional, rajonal ose lokal që ndihmon dhe mbështet viktimat.

Detyrimi për të rritur vetëdijësimin për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është pjesë e një varg detyrimesh në fushën e parandalimit të parapara në Kapitullin III të konventës<sup>2</sup>. Prandaj, duhet të konsiderohet në lidhje të ngushtë me këto dispozita, të cilat përcaktojnë një numër detyrimesh të përgjithshme për të sfiduar stereotipet dhe paragjykimet,

---

<sup>2</sup> Konventa e Stambollit në fuqi përbëhet nga një varg punimesh mbi detyrimet në fushën e parandalimit të përfshira në Kapitullin III të konventës. Shih, sidomos Hester M. dhe Lilley SJ (2014), *Parandalimi i dhunës ndaj grave: Neni 12 i Konventës së Stambollit*, Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg.



për të përfshirë burra dhe djem dhe për të fuqizuar gratë (neni 12), për të promovuar barazinë gjinore dhe rolet gjinore jo-stereotipizuese në arsim (neni 14), për të trajnuar profesionistë (neni 15), për të punuar me autorët e dhunës (neni 16) dhe për të përfshirë mediat dhe sektorin privat në përpjekjet parandaluese (neni 17).

Masat parandaluese janë pjesë kyçe e konventës, të plotësuara me detyrime të hollësishme për të mbrojtur dhe mbështetur viktimat, për të siguruar hetim efektiv dhe ndjekje penale në rastet e dhunës ndaj grave, dhe për të siguruar që këto detyrime shndërrohen në politika gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara që do të zbatohen përmes një bashkëpunimi efikas midis të gjithë akterëve relevantë (neni 7). Për më tepër, neni 11 kërkon që të bëhen përpjekje për të forcuar mbledhjen e të dhënave dhe hulumtimin për format e ndryshme të dhunës ndaj grave në mënyrë që politikat dhe masat e ardhshme të mund të mbështeten në një bazë njohurive të shëndosha.

Në këtë kontekst më të gjerë duhet të shihet detyrimi për të rritur ndërgjegjësimin dhe informuar publikun e gjerë për shërbimet ekzistuese. Kjo mund të jetë vetëm një pjesë e enigmës në përpjekje për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe është e ndërlidhur ngushtë me masat e tjera parandaluese që duhet të merren si pjesë e një pakoje gjithëpërfshirëse e politikave të bazuara në prova të identifikuara përmes hulumtimit dhe të dhënave.

# Roli i vetëdijësimit në parandalim

---

**K**onventa e Stambollit e pranon qartë se për të parandaluar dhunën ndaj grave, është e nevojshme të ndryshohen qëndrimet dhe sjelljet, e grave dhe burrave, të cilat shpesh ndikohen nga paragjykimet, stereotipet gjinore dhe zakonet ose traditat e njëanshme gjinore (neni 12). Sfidimi i miteve të hershme dhe keqkuptimeve rreth dhunës ndaj grave dhe adresimi i nocioneve të ngurta të mashkulloritetit dhe feminitetit janë ndër masat kryesore në këtë kontekst.

Për ta parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, ata që planifikojnë aktivitete vetëdijesuese duhet të kuptojnë pse ndodh një dhunë e tillë. Konventa e Stambollit integron të kuptuarit e dhunës ndaj grave të zhvilluar nga Komiteti i CEDAW i Kombeve të Bashkuara, veçanërisht përmes Rekomandimit të Përgjithshëm 19(1992) dhe e konsideron dhunën ndaj grave si të rrënjosur në pabarazinë gjinore. Preambula e Konventës së Stambollit pranon se "dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, të cilat kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat". Është e rëndësishme se të kuptuarit e dhunës ndaj grave bazohet në idenë se dhuna është fenomen shoqëror. Se ajo lind, riprodhohet dhe mbahet brenda rendit shoqëror dhe nga normat dhe praktikat shoqërore. Burrat që përdorin dhunën nuk janë të dhunshëm për 'nga natyra'; ata bëhen të dhunshëm përmes socializimit dhe ndërveprimit shoqëror, andaj ata mund ta ndryshojnë sjelljen e tyre. Kjo do të thotë që dhuna ndaj grave mund të parandalohet nëse ndërhyrjet adresojnë gamën e faktorëve që e nxisin ose e mundësojnë atë.

Shpjegimet e dhunës së burrave ndaj grave janë trajtuar në një varg disiplinash, mes tjerash duke nxjerrë teori biologjike, psikologjike, psikoanalitike, sociologjike, politike dhe ekonomike. 'Modeli ekologjik' i përdorur gjërësisht për të kuptuar dhunën ndaj grave ka sjellë së bashku

konceptualizimet e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe një mori faktorësh që hulumtimet kanë gjetur për të parashikuar abuzimin<sup>3</sup>. Këta faktorë u grupuan në nivelet vijuese: në nivelin e rendit shoqëror (makro), normave dhe praktikave shoqërore që rregullojnë jetën e përditshme (meso), bashkëveprimet ditor në rrethin e ngushtë (mikro) dhe historikun e jetës individuale (ontogjenetik). Hagemann-White et al. (2010) e ka zhvilluar këtë në një model interaktiv për të ilustruar se si faktorët e ndryshëm të rrezikut ndërthuren në nivele të ndryshme për të formuar shtigje të ndryshme që çojnë në dhunë me bazë gjinore ndaj grave<sup>4</sup>. Ky model interaktiv siguron një kornizë të dobishme për hartimin e strategjive për parandalim sepse nënvizon ato kontekste që janë të favorshme për kryerjen e dhunës, dhe për këtë arsye duhet të ndërpriten për të parandaluar në mënyrë efektive dhunën ndaj grave<sup>5</sup>. Në mënyrë ideale, masat e vetëdijesimit kontribuojnë në shkëputjen e këtyre shtigjeve dhe konteksteve të ndryshme në të gjitha nivelet në mënyrë që të parandalohet në mënyrë efektive dhuna me bazë gjinore. Megjithatë, është e rëndësishme të jemi të qartë - dhe realë - për rolin që vetëdijësimi mund - dhe nuk mund - të luajë në kontekstin e parandalimit.

## Çfarë dijmë për vetëdijësimin dhe parandalimin

---

Kur të shqyrtohet roli i veçantë i vetëdijesimit si pjesë e parandalimit, është e rëndësishme të merret në konsideratë dhe të pranohet dallimi mes

---

<sup>3</sup> Heise LL (1998), "Dhuna ndaj grave: një kornizë e integruar, ekologjike", *Dhuna ndaj Grave* 1998 vëll. 4, nr 3, faqe 262-290.

<sup>4</sup> Hagemann-White C. et al. Hagemann-White C. et al. (2010), *Faktorët që ndikojnë në ushtrimin e dhunës ndaj grave, dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës ndaj orientimit seksual - Një model interaktiv me shumë nivele* (pjesë e studimit të fizibilitetit për të vlerësuar mundësitë, shanset dhe nevojat për të standardizuar legjislacionin kombëtar për dhunën gjinore dhe dhunën ndaj fëmijëve për Komisionin Evropian), Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, gjenden në: [http://ec.europa.eu/justice/funding/daphne3/multi-level\\_interactive\\_model/understanding\\_perpetration\\_start\\_unix.html](http://ec.europa.eu/justice/funding/daphne3/multi-level_interactive_model/understanding_perpetration_start_unix.html).

Shih edhe: Cerise S. (2011), "Një botë e ndryshme është e mundur: një thirrje për veprim afatgjatë dhe të synuar për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave", Koalicioni i Dhunës kundër Grave (EVAW), Londër, fq. 18-19, gjendet në [www.endviolenceagainstwomen.org.uk/data/files/resources/19/a\\_diferent\\_world\\_is\\_possible\\_report\\_email\\_version.pdf](http://www.endviolenceagainstwomen.org.uk/data/files/resources/19/a_diferent_world_is_possible_report_email_version.pdf).

<sup>5</sup> Për analizë më të detajuar të kornizës së propozuar teorike për hartimin e masave për parandalimin e dhunës ndaj grave, shih Hester M. dhe Lilley SJ (2014), Parandalimi i dhunës ndaj grave: Neni 12 i Konventës së Stambollit, Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg.

ndryshimeve në vetëdijesim dhe rritjes së njohurive në njërin anë dhe ndryshimeve në qëndrime dhe në sjellje, në anën tjetër. Vetëdijësimi i rritur është pararendës i ndryshimeve në qëndrime dhe sjellje dhe mund të kontribuojë në krijimin e një mjedisi mbështetës për ndryshimin dhe zbatimin e politikave. Sidoqoftë, nuk mund të supozohet se një nivel më i lartë i vetëdijesimit dhe njohurive në vetvete do të dërgoj në ndryshime të qëndrimeve në lidhje me dhunën ndaj grave. Përkundrazi, ndryshimi i qëndrimeve, me qëllim të ndryshimit eventual të sjelljes, kërkon masa të mëtutjeshme edukative dhe një angazhim më të thellë dhe më afatgjatë. Nismat e vetëdijesimit duhet të kuptohen si element i rëndësishëm i një sërë masash gjithëpërfshirëse që synojnë përmirësimin e kapaciteteve për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe për të reaguar ndaj rasteve të tilla.

Duhet gjithashtu të theksohet se njohuritë aktuale janë të kufizuara kur është fjala te ndërlidhja mes parandalimit dhe vetëdijesimit dhe mënyra si këto intervenime kontribuojnë në pengimin e shtigjeve për kryerjen e dhunës ndaj grave. Një rritje e mbështetjes së qeverisë për hulumtime dhe vlerësime të mëtutjeshme siç kërkohet nga Konventa e Stambollit do të mundësojë intervenime që bazohen më shumë në të dhëna në fushën e parandalimit, përfshirë ngritjen e vetëdijesimit.

Që nga viti 2005, Këshilli i Evropës ka monitoruar shkallën në të cilën 47 vendet e saj anëtare janë duke zbatuar masat e përfshira në Rekomandimin Rec (2002) 5 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e grave nga dhuna. Raportet e monitorimit përmbajnë informacione thelbësore për nivelin e reagimit të shtetit ndaj dhunës ndaj grave, përmes legjislativës, politikave, shërbimeve, mbledhjes së të dhënave dhe masave parandaluese, përfshirë edhe vetëdijësimin. Megjithatë, raporti fundit monitorues pranon se "është shumë e vështirë të matet vetëdijësimi, e aq më pak të përkufizohet një tregues që mund të vlerësojë këtë në mënyrë krahasuese me kalimin e kohës".<sup>6</sup>

---

<sup>6</sup> Këshilli i Evropës (2014), "Studim analitik i rezultateve të rrethit të katërt të monitorimit të zbatimit të Rekomandimit Rec(2002)5 për mbrojtjen e grave kundër dhunës në vendet anëtare të Këshillit të Evropës", Këshilli i Evropës, Strasburg, fq. 35. Raportet më të fundit, si gjithë të tjerat, të monitorimit, janë publikuar dhe janë në dispozicion në uebfaqen përkatëse të Këshillit të Evropës: [www.coe.int/t/dghl/standardsetting/convention-violence/documentation\\_studies\\_publications\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/convention-violence/documentation_studies_publications_en.asp).

## **Përkufizimet**

---

Ekzistojnë interpretime dhe përkufizime të shumta që mundohen të përshkruajnë iniciativat vetëdijësuese. Ato variojnë nga përkufizime të ngushta deri te më të gjera, duke iu referuar informacioneve publike ose nismave të komunikimit mbi format dhe përhapjen e dhunës ndaj grave, shërbimeve të ndihmës dhe mjeteve juridike. Ato mund të përfshijnë edhe nocionin e rritjes së vetëdijes së edukatorëve dhe profesionistëve që merren me dhunën ndaj grave, të profesionistëve të mediave dhe politikëbërësve. Iniciativat e vetëdijesimit mund të jenë shumë të larmishme për sa i përket llojit të masave dhe akterëve shoqërorë që kontribuojnë në to dhe ato mund të ndërmerren në mjedise të ndryshme, në varësi të përmbajtjes dhe audiencës së synuar. Andaj, është e rëndësishme të merret në konsideratë që masat e parapara në nenin 13 nuk mund të dallohen lehtësisht nga masat e parapara me nenet e tjera të Konventës së Stambollit, siç janë ato që lidhen me fuqizimin e grave, me arsimin shkollor dhe aftësimin e profesionistëve dhe ato që lidhen me rolin kryesorë që mund të luajnë mediat dhe sektori privat.

# Dizajnimi dhe zbatimi i fushatave ose programeve të vetëdijësimit

---

## Fillimi

---

### Korniza e fushatave dhe programeve të vetëdijësimit

**P**ër të qenë efektive, nismat vetëdijësuese duhet të dizajnohen si masa më afatgjate dhe më të qëndrueshme (e jo të njëhershme) dhe të jenë pjesë e një pakoje të politikave të integruara, si plan veprimi ose strategji shtetërore shumëvjeçare kundër dhunës ndaj grave. Qeveria Franceze, për shembull, e ka marrë këtë qasje në planet e saj të njëpasnjëshme trevjeçare të veprimit kundër dhunës ndaj grave (2005-2007; 2008-2010; 2011-2013; dhe ai aktual, 2014-2016), secili prej të cilëve përfshin një strategji për komunikim të qëndrueshëm dhe masa të vetëdijësimit.

## Franca

■ Fushatat qeveritare për vetëdijesim kundër dhunës ndaj grave (2001 dhe çdo vit në periudhën 2006-2014) [www.stop-violences-femmes.gouv.fr](http://www.stop-violences-femmes.gouv.fr)

Në vitin 2000, Qeveria Franceze realizoi një studim në shkallë të gjerë mbi dhunën ndaj grave (ENVEFF), dhe më pas, zhvilloi një fushatë sensibilizuese (Break the Silence, 2001) bazuar në të gjeturat<sup>7</sup>. Që nga mesi i vitit 2000, Qeveria Franceze ka zbatuar plane trevjeçare të veprimit kundër dhunës ndaj grave, të cilat kanë përfshirë fushata vjetore të komunikimit që synojnë ngritjen e vetëdijes.

Fushatat përdorin njoftime për shërbime publike në media kryesore të shtypit dhe elektronike<sup>8</sup>, si dhe fletëpalosje, posterë dhe broshura. Fillimi i secilës fushatë vjetore zakonisht planifikohet të përkohë me Ditën Ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave, 25 nëntor.

Faqja e internetit e përmendur më lartë përcjell fushatat dhe ofron informacione mbi format e ndryshme të dhunës ndaj grave (dhuna seksuale, ngacmimi seksual, dhuna nga partneri intim, martesë e detyruar, gjymtimi gjeneral i femrës), një numër ndihmës, informacione për mbrojtjen e ofruar nga legjislacioni francez dhe informacione për gratë që kanë nevojë për ndihmë, si dhe për profesionistët që punojnë me viktime. Ajo po ashtu ofron informacione për OJQ-të që mund të kontaktohen për ndihmë.

Në vitin 2011, qëllimi kryesor i masave të vetëdijesimit ishte të bëhej e ditur se ekzistonte linja telefonike për ndihmë dhe të inkurajoheshin viktimat për të kërkuar ndihmë. Fushata është udhëhequr në partneritet me OJQ të specializuara (kryesisht rrjeti FNSF, i cili e menaxhoi linjën e ndihmës 2010-2012) dhe janë marrë masa për t'u ballafaquar me rritjen e parashikuar të thirrjeve për ndihmë<sup>9</sup>. Në vitin 2012, fokusi i fushatës së qeverisë për vetëdijesim ishte ngacmimi seksual, me një faqe interneti të dedikuar<sup>10</sup>. Fushata që filloi në 2013 inkurajon gratë për të kërkuar ndihmë dhe për të përdorur linjën kombëtare - 3919 - mbulueshmëria e së cilës u zgjerua në vitin 2014. Plani aktual i 4-të i Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave (2014-2016) siguron vazhdimësi të masave të tilla të vetëdijesimit.<sup>11</sup>

<sup>7</sup> OSBE (2009), *Sjellja e sigurisë në shtëpi: luftimi i dhunës ndaj grave në rajonin e OSBE-së*.

*Një përmbledhje e praktikave të mira*, OSBE, fq. 39-40, gjendet në [www.osce.org/gender/37438](http://www.osce.org/gender/37438).

<sup>8</sup> Videot e të gjitha fushatave janë në dispozicion këtu: [www.stop-violences-femmes.gouv.fr](http://www.stop-violences-femmes.gouv.fr)

<sup>9</sup> Shih [www.stop-violences-femmes.gouv.fr/IMG/pdf/dossierpresse.pdf](http://www.stop-violences-femmes.gouv.fr/IMG/pdf/dossierpresse.pdf) për detaje.

<sup>10</sup> Shih [www.stop-harcelement-sexuel.gouv.fr/](http://www.stop-harcelement-sexuel.gouv.fr/).

<sup>11</sup> Shih <http://stop-violences-femmes.gouv.fr/IMG/pdf/Plan-de-lutte-contre-les-violences.pdf>.

Zhvillimi i një strategjie vetëdijesimi kundër dhunës ndaj grave nënkupton ndarjen e burimeve të duhura financiare. Buxheti i një programi ose fushate vetëdijesuese duhet të jetë real kundrejt arritjes së qëllimeve. Në mjedise kur burimet publike janë të kufizuara, mund të ketë nevojë të kërkohen fonde shtesë (për shembull nga organet ndërqeveritare) ose kontribute jo-monetare (si hapësira reklamuese falas, shërbime dizajni/kreative ose anketuese, ose mbështetje nga institucionet akademike për monitorim dhe vlerësim) me qëllim që të realizohen fushatat.

## Zgjedhja e partnerëve

Dizajnimi i një iniciative vetëdijesimi kërkon njohuri të avancuara të komunikimit dhe të çështjes. Për zhvillimin e iniciativave vetëdijesuese kundër dhunës ndaj grave, qeveritë duhet të angazhojnë jo vetëm ekspertë të komunikimit, por në mënyrë të barabartë shoqërinë civile dhe partnerë të tjerë me ekspertizë përkatëse për këtë temë. Në veçanti janë OJQ-të e grave që janë të specializuara për eliminimin e dhunës ndaj grave të cilat kanë ekspertizën e nevojshme dhe shumë prej tyre kanë përvojë të gjatë në ngritjen e vetëdijesimit për këtë çështje. Qeveritë mund të marrin në konsideratë edhe delegimin e përgjegjësisë për iniciativat e vetëdijesimit te organizatat e shoqërisë civile me ekspertizë të gjerë mbi dhunën ndaj grave. Qeveria gjermane, për shembull, po e përdor këtë qasje dhe ka mbështetur fushatat e vetëdijesimit që janë dizajnuar dhe udhëhequr nga organizatat e shoqërisë civile.<sup>12</sup>

Ndikim të madh mund të ketë krijimi i një kornize që siguron hapësirë për të përfshirë më shumë partnerë, përfshirë sektorin e korporatave dhe mediat. Nisma shumëvjeçare në Turqi, ku janë krijuar sinergji mes qeverisë, Kombeve të Bashkuara, OJQ-ve dhe akterëve të sektorit privat dhe i fushatave, janë një shembull i potencialit për arritje shumë më të gjerë përmes ndërtimit të aleancave fleksibile me shumë palë të interesuara.<sup>13</sup>

---

<sup>12</sup> Shih

[www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/countryinformationpages/germany/NationalReport\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/countryinformationpages/germany/NationalReport_en.asp) - cf. "4.) Fushatat aktuale të mbështetura nga Qeveria Federale".

<sup>13</sup> Për detaje të fushatave dhe një përshkrim të procesit të angazhimit, shih [www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/countryinformationpages/turkey/](http://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/countryinformationpages/turkey/) and UNFPA (2007), *Programming to address violence against women. 10 studime rasti*, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, Nju Jork, fq. 57 f., gjendet në [www.unfpa.org/publish/global/pid/386](http://www.unfpa.org/publish/global/pid/386).



## Turqia

- Fushata Stop Dhunës ndaj Grave në Turqi (nga Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisë Turke për Statusin e Grave, KSGM, 2004-2008)

Në vitin 2004, shkalla e lartë e interesit publik për rezultatet e një studimi mbi të ashtuquajturat "vrasje nderi" u bë pikënisje për aktivitete të qëndrueshme të vetëdijesimit kundër dhunës ndaj grave në Turqi. Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisë turke për statusin e grave (KSGM), me mbështetje teknike nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), dizajnoi një fushatë informacioni dhe avokimi, fillimisht për një vit. Ajo përqendrohej në veçanti te burrat dhe përfshiu partneritete me sektorin privat dhe qeveritë lokale, si dhe një zëdhënës të famshëm, Federatën Turke të Futbollit, Federatën e Gazetarëve Turq, zyrtarë të lartë të qeverisë dhe udhëheqës fetarë. Lansimi i një fushate shtesë për vetëdijesim kundër dhunës në familje nga kompania private e mediave Hürriyet, botuese e gazetës ditore me shitjen më të madhe në Turqi, mundësoi krijimin e sinergjive të rëndësishme, duke dërguar në shtrirje dhe aktivitete më të gjera dhe më të qëndrueshme. Partneriteti me një medium të madh siguroi një mundësi të rrallë për të trajnuar gazetarë në vend të punës dhe të tjerë si të raportohen rastet e dhunës ndaj grave. Ajo gjithashtu ndihmoi në rritjen e raportimit për këtë çështje në gazetë dhe dërgoi në krijimin e një linje telefonike ndihme për rajonin e Stambollit, si dhe krijimin e një platforme për OJQ-të e grave për t'u dhënë grave zë në një gamë të gjerë temash.

Aktivitetet e fushatës u zbatuan krahas masave teknike dhe politike, siç janë trajnimi i profesionistëve të sektorit publik, policisë, udhëheqësve fetarë dhe gazetarëve, si dhe më shumë hulumtimeve për të informuar zhvillimin e politikave të reja (përfshirë një plan kombëtar veprimi për ta luftuar dhunën në familje, ngritjen e strehimoreve të reja për gratë dhe një linjë telefonike), duke krijuar kështu mbështetje publike për këto nisma.<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup> Për detaje të fushatave dhe një përshkrim të procesit të angazhimit, shih [www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/countryinformationpages/turkey/](http://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/countryinformationpages/turkey/) and UNFPA (2007), op. cit.

## Përgatitja e një fushate apo programi vetëdijesues

Përgatitja e një fushate apo programi vetëdijesimi duhet të bazohet në objektiva të përkufizuara qartë, rezultate të pritura dhe aktivitete të dizajnuara për t'i arritur ato (modeli logjik). Formulimi i qëllimeve dhe objektivave, përcaktimi i qartë se vetëdijesimi i kujt duhet të bëhet dhe për çfarë, pse është zgjedhur kjo audiencë dhe si do të arrihet, do të ndihmojë në qartësimin e kontributit të pritshëm drejt strategjisë më të gjerë për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave. Kjo gjithashtu do të sigurojë kornizën për vlerësimin e efektivitetit të masës.

Pritjet në lidhje me rezultatet ose ndikimin e një fushate apo programi vetëdijesimi duhet të jenë realiste.<sup>15</sup> Ndërsa ndryshimet në qëndrime dhe sjellje kërkojnë masa të mëtijshme, fushata ose programe vetëdijesimi të cilat mund të ndihmojnë për "thyerjen e heshtjes" dhe të kontribuojnë në të kuptuarit se dhuna ndaj grave është çështje publike, e cila duhet të adresohet nga qeveria dhe shoqëria në tërësi. Sigurimi i informacionit të saktë në lidhje me format dhe mbizotërimin e dhunës si dhe ndikimin tek fëmijët, është një hap i parë dhe thelbësor dhe mund të ndihmojë në shpërbërjen e miteve dhe rritjen e të kuptuarit të atyre që preken nga dhuna, si dhe të "soditësve", dhe ofrimin e sugjerimeve se si të ndërhyhet dhe të sfidohet dhuna dhe qëndrimet që e falin atë. Vetëdijesimi për mjetet juridike dhe mjetet e tjera ekzistuese dhe shërbimet mbështetëse mund të ndihmojë në inkurajimin e viktimave të kërkojnë mbështetje dhe kompensim dhe keqbërësve që të kërkojnë trajtim.

Dizajnimi i një iniciative efektive të vetëdijesimit duhet të bazohet në njohuri të thella të çështjes, grupit të synuar, kanaleve më të mira për arritjen e tyre dhe mesazheve më efikase. Për shembull, të dhëna nga një studim për

---

<sup>15</sup> Në lidhje me pritjet realiste të fushatave të avokimit mbi dhunën ndaj grave (të cilat gjithashtu japin njohuri të rëndësishme për fushatat e vetëdijesimit), shih Qendrën e Njohurisë Virtuale të Grave të KB për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave në [www.endvawnow.org/en/articles/1155-what-can-one-expect-from-a-campaign-to-end-vaw.html](http://www.endvawnow.org/en/articles/1155-what-can-one-expect-from-a-campaign-to-end-vaw.html). Organizata Botërore e Shëndetësisë gjithashtu paralajmëron se "është e vështirë për të matur ndryshimet e mundshme të niveleve të dhunës të ndërlidhura me intervenimet mediatike", ndërsa nënvizon se hulumtimet sugjerojnë se të kuptuarit e sjelljes së audiencës së tyre dhe angazhimi i anëtarëve të saj në përgatitjen e intervenimeve janë kyçe. Shih OBSH(2009), "Parandalimi i dhunës: provat. Promovimi i barazisë gjinore për të parandaluar dhunën ndaj grave (Përmbledhje informuese për parandalimin e dhunës), Organizata Botërore e Shëndetësisë, gjendet në [http://whqlibdoc.who.int/publications/2009/9789241597883\\_eng.pdf](http://whqlibdoc.who.int/publications/2009/9789241597883_eng.pdf).

vetëdijesim rreth një çështjeje në pjesë të veçanta të popullatës mund të sigurojë bazën fillestare për të dizajnuar masën e vetëdijesimit, por edhe për të vlerësuar efektivitetin e saj, nëse të dhënat e krahasueshme mund të mblidhen më pastaj.

Në disa raste, si hap i parë në përgatitjen e një mase vetëdijesuese mund të jetë kryerja e hulumtimeve për të mbledhur të dhëna të nevojshme. Të dhënat në dispozicion nga mbarë BE-ja për shtrirjen dhe natyrën e dhunës në baza gjinore ndaj grave pas shpalesjes së gjetjeve të sondazhit të Agjencisë për të Drejtat Themelore për dhunën ndaj grave (2014)<sup>16</sup> mund të sigurojnë të dhëna të dobishme për historikun e iniciativave të vetëdijesimit në 28 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që janë anëtare të Bashkimit Evropian. Njësoj, raporti i veçantë i Eurobarometrit për dhunën në familje ndaj grave (2010)<sup>17</sup> përmban rezultatet e një studimi të kryer në gjithë BE-në për vetëdijen dhe përshtypjet e publikut mbi dhunën në familje, dhe një studimi i ngjashëm pasues i opinionit i kryer një dekadë më parë,<sup>18</sup> siguron informacion të vlefshëm për ndryshimet në vetëdijesim dhe qëndrimet ndaj kësaj forme të dhunës.

## Rëndësia e vlerësimit

Me gjithë mësimet e nxjerra nga praktika që disa dekada, masat e vetëdijesimit për dhunën ndaj grave në Evropë vlerësohen rrallë, e as rezultatet dhe ndikimi i tyre nuk vlerësohen në mënyrë sistematike.<sup>19</sup> Mungesa e përgjithshme e të dhënave (të krahasueshme) dhe hulumtimeve mbi dhunën ndaj grave përbënë pengesë në këtë kontekst, të cilën Konventa e Stambollit, në dispozitat e saj në lidhje me mbledhjen dhe hulumtimin e të dhënave (neni

---

<sup>16</sup> Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (2014), *Dhuna ndaj grave: një studim në gjithë BE-në*. Rezultatet kryesore, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, gjenden në <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/vaw-survey-main-results>.

<sup>17</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Komunikim (2010), *Eurobarometer 73.2: Dhuna në familje ndaj grave*, TNS Opinion & Social, Bruksel. Në dispozicion në: [http://ec.europa.eu/public\\_opinion/archives/ebs/ebs\\_344\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/ebs/ebs_344_en.pdf).

<sup>18</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian X për Informim, Komunikim, Kulturë dhe Media Audiovizuale (1999), *Eurobarometer 51.0: Evropianët dhe pikëpamjet e tyre mbi dhunën në familje ndaj grave*, Bruksel. Gjendet në: [http://ec.europa.eu/public\\_opinion/archives/ebs/ebs\\_127\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/ebs/ebs_127_en.pdf).

<sup>19</sup> Komisioni Evropian (2012), *Shkëmbim i praktikave të mira mbi barazinë gjinore: aktivitete sensibilizuese për luftimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Raport përmbledhës*, Komisioni Evropian (Drejtësi), Mbretëria e Bashkuar, fq. 12-13, gjendet në [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/fles/exchange\\_of\\_good\\_practice\\_uk/summary\\_report\\_uk\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/fles/exchange_of_good_practice_uk/summary_report_uk_2012_en.pdf).

11), synon ta adresojë. Megjithatë, duhet të theksohet se matja e ndikimit të iniciativave apo fushatave vetëdijesuese (sa i përket kontributit të tyre për parandalim) në përgjithësi është sfidë, për shkak të shumësisë dhe kompleksitetit të faktorëve që i kontribuojnë dhunës ndaj grave dhe eliminimin e saj.<sup>20</sup>

Prandaj është me rëndësi thelbësore që hartimit të kornizës së vlerësimit për një iniciativë vetëdijesimi t'i kushtohet vëmendja e duhur, përfshirë shpërndarjen e nevojshme të burimeve.

## **Përzgjedhja e mesazheve dhe audiencës**

---

Mesazhet e vetëdijesimit duhet të bazohen në një përkufizim të qartë të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, me mirëkuptim për të drejtat njerëzore dhe çështjet gjinore, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit (neni 3). Ato duhet të adresojnë jo vetëm efektet, por edhe rrënjët e problemit të dhunës ndaj grave: pabarazinë gjinore dhe diskriminimin, si dhe normat dhe stereotipet që tolerojnë dhe mbështesin dhunën ndaj grave.

## **Adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje**

Meqenëse neni 13 përmban detyrimin për të rritur vetëdijesimin dhe të kuptuarit nga ana e publikut të gjerë për manifestimet e formave të ndryshme të dhunës të mbuluara nga konventa, si dhe ndikimin e tyre tek fëmijët, shtetet palë duhet të sigurojnë vetëdijesimin për të gjitha këto aspekte. Në të gjithë rajonin, vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë zbatuar një gamë të gjerë të iniciativave për sensibilizimin, dhe/ose kanë dhënë mbështetje (financiare ose në forma të tjera) për nismat e vetëdijesimit, të cilat drejtoheshin nga

---

<sup>20</sup> Shih shembuj të metodologjive për të vlerësuar ndikimin në fushatat në Qendrën e Njohurive Virtuale të Grave të Kombeve të Bashkuara për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave (2011), Fushata për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave, Gratë e KB, veçanërisht Kapitulli 7.10: Vlerësimi i ndikimit në fushata, gjendet në [www.endvawnow.org/en/articles/1339-assessing-impact-in-campaigns.html?next=1340](http://www.endvawnow.org/en/articles/1339-assessing-impact-in-campaigns.html?next=1340) and tools for evaluation of mass communications initiatives, në Kapitullin 7.9: Vlerësimi i fushatës, gjendet në [www.endvawnow.org/en/articles/1336-special-tools-to-evaluate-mass-communication-activities.html?next=1337](http://www.endvawnow.org/en/articles/1336-special-tools-to-evaluate-mass-communication-activities.html?next=1337); Kapitulli 1.5: *Çfarë mund të pritet nga një fushatë kundër dhunës ndaj grave (VAW)?* gjendet në [www.endvawnow.org/en/articles/1155-what-can-one-expect-from-a-campaign-to-end-vaw.html](http://www.endvawnow.org/en/articles/1155-what-can-one-expect-from-a-campaign-to-end-vaw.html); mbi kompleksitetin e faktorëve që çojnë në ushtrimin e dhunës ndaj grave, cf. Hagemann-White, C. et al. (2010), op. cit.

organizata të specializuara joqeveritare. Lloji i dhunës ndaj grave që është adresuar më rregullisht dhe më gjerësisht - përfshirë edhe përmes dy fushatave<sup>21</sup> në mbarë Evropën - është dhuna e partnerit intim ose dhuna në familje. Në vendet ku iniciativat e vetëdijesimit janë realizuar vetëm në disa aspekte dhe forma të dhunës ndaj grave, ato që nuk janë mbuluar ende duhet të adresohen si çështje prioritare, në kuadër të një strategjie afatgjatë që do të sigurojë që me kalimin e kohës të adresohen të gjitha llojet e dhunës, përfshirë dhunën që prek veçanërisht gratë më të cenueshme ose të marginalizuara.

## Audienca dhe nocioni i "depërtimit të publiku i gjerë"

Nocioni "publiku i gjerë" i referohet kolektivisht grupeve të ndryshme në shoqëri, tek të cilat duhet të arrijnë informacionet në lidhje me shkallën dhe format e dhunës ndaj grave, nevojën për ta ndaluar atë dhe mjetet dhe shërbimet në dispozicion për viktimat. Sidoqoftë, kur përgatitet një masë për ngritjen e vetëdijes, është e rëndësishme të sigurohet që mesazhet të krijohen posaçërisht për të arritur dhe për t'u dëgjuar nga njerëzit që duhet t'i dëgjojnë ato. Është detyrim i shteteve palë nënshkruese të sigurojnë që të gjithë anëtarët e publikut të gjerë (pavarësisht nga mosha, klasa, gjinia, përkatësia etnike, etj., qofshin viktimë, autorë i dhunës, profesionistë që punojnë me secilën nga këto kategori, politikëbërës, opinionistë, etj.) të adresohen përmes masave të vetëdijesimit që janë krijuar për t'i arritur ata në mënyrë efektive. Kështu që zbatimi i këtij detyrimi të Konventës së Stambollit kërkon një sërë masash të ndryshme, duke synuar audiencën specifike me mesazhe të ndryshme, të cilat janë pjesë e një strategjie të përgjithshme më afatgjate për vetëdijesim që mbulon të gjitha pjesët e popullatës.

## Audienca kyçe

Shumë nisma të vetëdijesimit për dhunën ndaj grave të udhëhequra nga sektorë qeveritarë ose shoqëria civile kanë adresuar - në mënyrë eksplicite apo implicite - gratë si viktimë (të mundshme) të formave të ndryshme të dhunës.<sup>22</sup> Viteve të fundit është pranuar gjithnjë e më shumë se është po aq e rëndësishme të rritet vetëdijesimi i burrave dhe djemve - jo vetëm si keqbërës

---

<sup>21</sup> Fushata evropiane njëvjeçare e Bashkimit Evropian kundër Dhunës në Familje në vitin 1999 dhe Fushata e Këshillit të Evropës për Luftimin e Dhunës ndaj Grave, përfshirë Dhunën në Familje nga 2006 deri në 2008: [www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/](http://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/).

<sup>22</sup> Mesazhet e fushatave të njohura dhe të përhapura i ftojnë gratë viktimë ta "thyejnë heshtjen", "të flasin", të dinë për të drejtat e tyre ligjore dhe të kontaktojnë shërbimet e ndihmës.

të mundshëm, por edhe si anëtarë të shoqërisë, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në sfidimin e seksizmit dhe dhunës mashkullore kundër grave mes kolegëve të tyre.<sup>23</sup>

Gjithashtu, rëndësia e targetimit të të rinjve për të sfiduar sjelljen abuzive në marrëdhëniet adoleshente dhe stereotipet bazike gjinore që e nxisin atë është rritur,<sup>24</sup> poashtu dhe për të synuar grupe veçanërisht të marginalizuara përmes masave specifike. Kur përzgjidhet audienca e masave për ngritjen e vetëdijes, është e rëndësishme të merret parasysh që të adresohen edhe ato që nuk janë mbuluar ende si çështje prioritare, brenda një strategjie afatgjate që do të sigurojë që me kalimin e kohës, të gjithë anëtarët e shoqërisë të jenë përfshier.

## Konsiderata etike

Zgjedhja e gjuhës dhe imazheve në përpjekje për të rritur vetëdijesimin kundër dhunës ndaj grave, duhet të merret në konsideratë me kujdes. Disa lloje të mesazheve dhe pamjeve mund të forcojnë mitet, stereotipet dhe qëndrimet për fajësimin e viktimave që përjetësojnë një mjedis të favorshëm për dhunën ndaj grave. Imazhet e qarta të dhunës dhe abuzimit mund të tërheqin vëmendjen përmes "efektit shokues", por është e rëndësishme të merren parasysh implikimet e një qasjeje të tillë. Gjithashtu, ndonëse deklarimet personale të viktimave mund të jenë një mjet i fortë për të përcjellë një mesazh, kjo duhet të bëhet publike vetëm pasi të merren parasysh me kujdes implikimet për sigurinë e tyre emocionale dhe fizike. Andaj përfshirja e profesionistëve që punojnë kundër dhunës ndaj grave - që shpesh janë OJQ-të e specializuara të grave - në përpilimin e mesazheve është kyçe për të siguruar që perspektivat e viktimave të merren parasysh.

Është po ashtu e këshillueshme që të konsultohen rekomandimet ekzistuese, udhëzimet dhe listat kontrolluese se "çka mund e çka nuk mund të bëni" në

---

<sup>23</sup> Një shembull është komponenti vetëdijesues i projektit Rritja e Parandalimit dhe Reagimit ndaj Dhunës në Familje në Gjeorgji (SHIEld), i cili përfshin mesazhe të drejtuara për burrat e moshës 18-65 vjeçare në lidhje me promovimin e tolerancës zero ndaj ushtrimit të dhunës në familje ndaj grave, shih UN Women (2011), "Rritja e Parandalimit dhe Reagimit ndaj Dhunës në Familje në Gjeorgji - SHIEld", raporti përfundimtar i vlerësimit, gjendet në [www.endvawnow.org/uploads/browser/fles/shield\\_communications\\_report\\_fnal\\_fnal.pdf](http://www.endvawnow.org/uploads/browser/fles/shield_communications_report_fnal_fnal.pdf).

<sup>24</sup> Fushata e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar, "Ky është abuzim" është shembull i një fushate të tillë që synon të rinjtë: <http://thisisabuse.direct.gov.uk/>.

komunikim në lidhje me dhunën ndaj grave. Për shembull, instrumenti i hartuar nga UNIFEM (tani UN Women) për komunikime strategjike për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave, thekson këtë dhe siguron një listë të atyre që "mund dhe nuk mund të bëni", përfshirë rekomandimet për fuqizimin e mesazheve.<sup>25</sup> Në Irlandë, Zyra Kombëtare për Parandalimin e Dhunës në Familje, Dhunës Seksuale dhe me bazë Gjinore (COSC) ka botuar një udhëzues për grupet që marrin grante nga COSC për iniciativat e vetëdijesimit/komunikimit.<sup>26</sup>

Zyra e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për Barazi ka botuar udhëzuesin "Trajtimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave: udhëzues për komunikim të praktikave të mira", i cili synon komunikuesit e qeverisë që punojnë në fushën e dhunës ndaj grave dhe vajzave.<sup>27</sup>

---

<sup>25</sup> UNIFEM (2003), *Duke bërë ndryshim: komunikimet strategjike për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave*, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave, Nju Jork, fq. 16, gjendet në [www.endvawnow.org/en/tools/view/342-making-a-diference-strategic-communications-to-end-violence-against-women-2003.html](http://www.endvawnow.org/en/tools/view/342-making-a-diference-strategic-communications-to-end-violence-against-women-2003.html).

<sup>26</sup> COSC (2013), "Dokumenti i komunikimit për qasjet e promovimit dhe zhvillimit të të kuptuarit të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe gjinore", Zyra Shtetërore për Parandalimin e Dhunës në Familje, Dhunës Seksuale dhe Gjinore (COSC), Dublin, gjendet në [www.cosc.ie/en/COSC/Communications](http://www.cosc.ie/en/COSC/Communications), dhe COSC "Parimet udhëzuese për aktivitetet e ndërgjegjësimit publik lidhur me dhunën në familje, dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore" gjendet në [www.cosc.ie/en/COSC/Cosc%20%20Guidance%20Principles%20Document%20-%20updated%2017th%20June%202011.pdf/Files/Cosc%20%20Guidance%20Principles%20Document%20-%20updated%2017th%20June%202011.pdf](http://www.cosc.ie/en/COSC/Cosc%20%20Guidance%20Principles%20Document%20-%20updated%2017th%20June%202011.pdf/Files/Cosc%20%20Guidance%20Principles%20Document%20-%20updated%2017th%20June%202011.pdf).

Organizatat e specializuara të shoqërisë civile, ndonëse e vlerësojnë përgjithësisht iniciativën, kanë ngritur disa çështje, përkatësisht faktin që Plani Kombëtar i Veprimit i Qeverisë për Dhunën në Familje, Dhunën Seksuale dhe Gjinore, nuk merr parasysh në mënyrë të duhur dimensionin gjinor të dhunës ndaj grave. Gjithashtu, një shembull i një fushate që ka përdorur mesazhe "të thjeshta dhe efektive" sipas udhëzuesit nuk konsiderohet se ka qenë efikas nga disa OJQ të specializuara. Kjo vë në pah nevojën për vlerësime shkencore për të vlerësuar saktë efektet/rezultatet e komunikimit/iniciativave të vetëdijesimit.

<sup>27</sup> Zyra Qeveritare për Barazi (2009), *Luftimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave. Udhëzues për komunikimet e praktikave të mira*, Londër, gjendet në [http://sta.geo.useconnect.co.uk/news/vaw\\_guidance.aspx](http://sta.geo.useconnect.co.uk/news/vaw_guidance.aspx). Fakti që udhëzuesi u hartua nga një agjenci e marrëdhënieve me publikun (PR), pa përfshirjen e OJQ-ve të specializuara, u ngrit nga disa ekspertë të angazhuar në këtë aktivitet.

## Zgjedhja e Mesazheve

Të siguarit që mesazhet të jenë të përshtatshme për kontekstin kombëtar ose lokal është thelbësor, si në lidhje me llojin e pamjeve, ashtu edhe në lidhje me referencat kulturore dhe faktorët e tjerë të rëndësishëm. Në disa kontekste kombëtare ose lokale mund të jetë më e pranueshme se në vende të tjera të përdoren imazhe grafike. Në vende të tjera, mund të jetë më e fuqishme të krijohen efektet e nevojshme "shokuese" duke përdorur mënyra më delikate për të përcjellë një mesazh. Një shembull i kësaj qasjeje mund të gjendet në Fushatën Zero Tolerancë të iniciuar në Skoci në vitin 1992, e cila paraqiti imazhe paqësore të kombinuara me fakte të forta në lidhje me dhunën në familje në vend që të përshkruanin dhunë, lëndime ose viktimizime të çfarëdo lloji. Në të vërtetë, ishte ballafaqimi i imazheve me tekstin që krijoi "efektin shokues" dhe që tërhoqi vëmendjen e shikuesve.<sup>28</sup> Në Belgjikën frankofone, Fred et Marie/Marie et Fred, një iniciativë vetëdijesimi mbi dhunën psikologjike të partnerit intim, përdorë një "varg" të filmave të shkurtër që portretizojnë në mënyrë josenzacionaliste, vëzhguese, sjellje të dhunshme psikologjike në një marrëdhënie dhe reagimet si nga viktima ashtu edhe nga vrojtuesit.<sup>29</sup>

■ Fushata zero tolerancë - Edinburg, Skoci, 1992  
[www.zerotolerance.org.uk](http://www.zerotolerance.org.uk)

Në vitin 1992, Komiteti i Grave i Këshillit të Qarkut në Edinburg (Skoci, Britani e Madhe), në bashkëpunim me organizatat lokale të grave, inicioi Fushatën Zero Tolerancë, fushata e parë për ngritjen e vetëdijes publike në Evropë, duke u përpjekur të sfidojë qëndrimet sociale ndaj sulmit fizik dhe seksual kundër grave dhe vajzave dhe për të shpërbërë mitet dhe stereotipet për dhunën e burrave ndaj grave.

Ajo u zhvillua për gjashtë muaj në qytetin e Edinburgut dhe u përqendrua në përhapjen e dhunës ndaj grave.<sup>30</sup> Posterë me imazhe dhe mesazhe të ndryshme u shfaqën në postera dhe mure, si dhe në ndërtesa publike në të gjithë qytetin. Duke u bazuar në hulumtime dhe përvojat e grave dhe fëmijëve, posterët përdorën fotografi bardh e zi dhe tekst të matur e faktik që thyente disa nga mitet më të përhapura mbi dhunën ndaj grave dhe

<sup>28</sup> Kitzinger J. (1994), "Sfidimi i dhunës seksuale ndaj vajzave: një qasje e vetëdijes sociale", *Rishikimi i Abuzimit të Fëmijëve*, vëll. 3, Nr. 4, faqe 246-248, gjendet në <http://cf.ac.uk/jomec/resources/ABUSEREV.pdf>.

<sup>29</sup> Shih [www.fredetmarie.be/](http://www.fredetmarie.be/); [www.marieetfred.be/](http://www.marieetfred.be/).

<sup>30</sup> Shih <http://zerotolerance.org.uk/projects/PreviousCampaigns/1/13>.



vajzave. Vënia e imazheve të qeta e me stil përballë fakteve tronditëse në lidhje me dhunën e burrave ndaj grave dhe vajzave u tregua mjaft efektive si strategji, dhe një vlerësim i fazës së parë të fushatës tregoi se fushata dhe mesazhet e saj u pranuan mirë nga publiku në Edinburg.<sup>31</sup> Materialet e tjera të përpiluara në kontekst të fushatës përfshinin dosje informuese, kartolina dhe një fletëpalopsje të shpërndara në Bibliotekën Komonale. Mbulimi i gjerë medial u sigurua përmes partneriteteve mediatike në nivel lokal dhe kombëtar. Ngjarje për profesionistët dhe për publikun e gjerë u organizuan si pjesë e fushatës.

Pesë posterët bardhë e zi të përgatitur në fushatën fillestare më shumë se njëzet vjet më parë mbesin edhe sot e kësaj dite referencë për praktikën e mira të sensibilizimit kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Poster i parë tregonte dy vajza duke luajtur dhe shkruante: "Deri në momentin kur ato mbushin 18 vjet, njëra prej tyre do t'i nënshtrohet abuzimit seksual". I dyti përqendrohej në shtrirjen e dhunës seksuale në jetën e grave dhe shkruante: "Nga moshën tre deri në moshën nëntëdhjetë vjeçare - gratë përdhunohen", duke theksuar po ashtu rrezikun për gratë nga burrat që ato njihnin me një fjali përmbyllëse "Burri, babai, i panjohuri - abuzimi me pushtetin nga burrat është krim". Poster i tretë përqendronte vëmendjen te dhuna në familje me mesazhin: "Ajo jeton me një biznesmen të suksesshëm, baba të dashur dhe një anëtar të respektuar të komunitetit. Javën e kaluar ai e bëri për spital." Një poster i katërt përmbante sloganin "Askush nuk ka të drejtë" në lidhje me të gjitha format e dhunës të përfshira në fushatë. Dhe poster i fundit, i pesti me radhë, përqendrohej te të rinjtë me mesazhin: "Kur ato thonë jo, mendojnë jo. Disa burra nuk dëgjojnë".

Fushata për ngritjen e vetëdijes siguroi një momentum dhe përqendrim për aktivitete të mëtejshme në lidhje me ndryshime ligjore dhe të politikave dhe rezultoi në formimin e një grupi të pavarur presioni për të vijuar më tej. Zero Toleranca ka bërë emër si ndërmarje që vazhdimisht del me fushata të reja dhe inovative të vetëdijesimit të cilat po vazhdojnë edhe sot e kësaj dite dhe se qasja e saj ka frymëzuar fushata të shumta në gjithë Mbretërinë e Bashkuar dhe në Evropë.

---

<sup>31</sup> Kitzinger J. (1994), op. cit.

Mesazhet që shpalosin fakte të sakta mbi dhunën ndaj grave mund të rrisin vetëdijesimin për këtë çështje dhe të ndihmojnë thyerjen e miteve dhe koncepteve të gabuara. Është shumë e rëndësishme të shmangen mesazhet që përmbajnë informacione të pasakta, që përjetësojnë mitet ose që krijojnë frikë joproporcionale. Për shembull, në vendet ku shkalla e dënimit për përdhunim është shumë e ulët (siç është në të gjitha vendet evropiane), një mesazh që u drejtohet burrave duke u thënë se përdhunimi do të çojë në burgosjen e tyre është jo i duhur dhe si rrjedhojë edhe i padobishëm. Ngjajshëm, mesazhet që paralajmërojnë gratë e reja për rreziqet e dhunës seksuale të lidhura me sjelljen e tyre kur shoqërohen në bare ose klube janë kundërproduktive pasi ato vendosin përgjegjësinë te viktimat e mundshme, më tepër se te kryesit e veprës.<sup>32</sup>

Mesazhet duhet të ofrojnë informacione të sakta mbi format e dhunës, përhapjen e saj, pasojat dhe mjetet juridike, si dhe mbështetjen e disponueshme për ata që janë prekur dhe duhet të propozojnë ndonjë formë veprimi që mund të ndërmerret. Një thirrje për veprim në kontekstin e një nisme vetëdijesimi, për shembull, mund të:

- ▶ inkurajojë viktimat të flasin ose të kërkojnë ndihmë (telefononi ndihmën, vizitoni faqet e internetit ose në qendër këshillimi) dhe t'i shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion;
- ▶ inkurajojë të pranishmit të intervenojnë dhe ta ngrisin zërin kur janë dëshmitarë të dhunës;
- ▶ inkurajojë qytetarët të mbështesin një propozim të ri ligjor ose zbatimin e legjisllacionit ekzistues.

Është po ashtu e rëndësishme të merret në konsideratë që, për pjesë të caktuara të popullatës, informacioni duhet të vihet në dispozicion në gjuhën që ata kuptojnë, e cila mund të mos jetë gjuha zyrtare e atij vendi ose rajoni.<sup>33</sup>

Testimi paraprak i mesazheve me grupet e synuara, si dhe me viktimat, do të ndihmojë për të siguruar që ato të jenë efektive me audiencën e synuar dhe do të ndihmojë në parandalimin e dëmit të paqëllimshëm.

---

<sup>32</sup> Brooks O. (2011), "Djema! Ndaleni! Pranimi dhe refuzimi i këshillave të sigurisë nga gratë kur shoqërohen në bare, kafene dhe klube", *British Journal of Criminology* 2011, vëll. 51, numri 4, faqe 635-651.

<sup>33</sup> Cf. Qeveria daneze Fushata Thyej Heshtjen në vitin 2003, e cila u fillua në gjuhë të shumta në: <http://eige.europa.eu/content/stop-violence-against-women-break-the-silence-0>.

## Mjetet dhe mediat për ta përcjellë mesazhin

---

Zgjedhja e mjeteve ose mediave për një fushatë apo program vetëdijesimi varet nga një numër faktorësh. Përshtatshmëria e tyre për të arritur audiencën duhet të jetë faktori kyç, por edhe aspektet e tjera si disponueshmëria e burimeve (financiare) janë po aq të rëndësishme. Duhet të merret në konsideratë një gamë e gjerë kanalesh dhe qasjesh.

### Kanalet

Kanalet klasike të marketingut përdoren shpesh në fushata sensibilizuese me qëllim që të mbulohet pjesa dërmuese e popullatës. Njoftimet për shërbime publike në TV, radio ose në media të shtypura janë shumë të popullarizuara, siç janë posterët reklamues në hapësira publike (tabelat në sheshet kryesore, stacione të autobusëve, trenave, etj.), shpërndarja e fletëpalosjeve, kartolinave, etj. Përdorimi i këtyre kanaleve të komunikimit në përgjithësi kërkon ose një buxhet të konsiderueshëm, ose një marrëveshje pro bono me kompanitë e mediave. Një zgjidhje tjetër mund të jetë eksplorimi i mediave origjinale, alternative për të përhapur mesazhe vetëdijesimi, siç është bërë në Turqi (etiketa në veshje) dhe Gjermani (paketime të letrës higjienike ose qeseve të furrave, shih më poshtë).

### Gjermani

- Fushata me qese furrash: "Përdhunimi/Dhuna - jo në çantën time"<sup>34</sup>  
("Vergewaltigung/Gewalt kommt nicht in die Tüte")

Në vitin 2001, qeveria e qytetit të Saarbrückenit (Gjermani) u bashkua dhe mbështeti një fushatë sensibilizuese për dhunën seksuale, e cila ishte iniciuar nga organizata lokale të specializuara të shoqërisë civile (qendra e krizës së përdhunimeve dhe shoqatës së planifikimit të familjes). Fushata përdori një medium të pazakontë për të mbuluar sektorë të ndryshëm të popullatës lokale me informacione faktike dhe statistika që theyejnë mitet rreth dhunës seksuale dhe informacione mbi linjat ndihmëse të disponueshme për personat që preken nga dhuna seksuale. Informacionet u shtypën në pjesën e përparme të qeseve prej letre që zakonisht përdoren

---

<sup>34</sup> "Jo në çantën time" është një shprehje gjermane që do të thotë "në asnjë mënyrë" ose "nuk mbështesim diçka".

për të shitur bukë dhe pasta në furrat gjermane. Pjesa e pasme e qeseve të letrës përmbante informacione për një kalendar të ngjarjeve në lidhje me temën, që mbaheshin në periudhën dymujore gjatë së cilës çantat e letrës u shpërndanë në furrat e bukës në qytet dhe rajon. Fushata u integrua në aktivitetet e qeverisë lokale për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave para Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, 25 Nëntor, dhe arriti kulmin në atë ditë. Pa përdorur ndonjë pamje ose formulim shokues, mesazhi ishte "goditës i fortë", pasi erdhi në një kontekst të papritur dhe për shumë pranues, si gjëja e parë në mëngjes kur blenë bukë dhe pasta për mëngjes. Përdorimi i një mediumi të pazakontë për informacion mbi dhunën seksuale, një artikulli i përditshëm, i cili është i lidhur me ushqimin dhe shpesh futet në kuzhinën e dikujt, nxiti jo vetëm debat të gjallë midis klientëve të furrave, por edhe interesim nga mediat, duke zgjeruar kështu shtrirjen e fushatës. Në veçanti, ishte qendra e krizës së përdhunimeve që e vlerësoi mundësinë për ta shpërndarë numrin e tyre të ndihmës sa më shumë dhe në një mënyrë të thjeshtë. Që nga atëherë fushata është përsëritur në të gjithë vendin dhe më gjerë, dhe është bërë fushatë vjetore në disa komuna ose "shtete federale" në Gjermani. Fushata frymëzoi aktivitete të ngjashme në vitet pasuese: fushata të tjera që përfshinin "media" të tjera të pazakonta (për shembull pako letrash higjienike në barnatore).

Përdorimi i mjeteve kreative, artistike mund të jetë instrument i fuqishëm për të transmetuar një mesazh dhe për të prekur audiencën në nivele të ndryshme e jo vetëm përmes informacionit faktik. Projekti teatror *Ferite A Morte* (e plagosur deri në vdekje), bazuar në histori lajmesh për gra që janë vlarë nga (ish) partnerët e tyre në Itali, është një shembull i përdorimit të artit për të rritur vetëdijesimin për pasojat më ekstreme të dhunës ndaj grave - vdekjes.<sup>35</sup>

## **Bartësit e porosisë**

Personalitete të famshme që kanë ndikim në një audiencë të caktuar mund të ndihmojnë për të ngjallur interesimin për një mesazh në mesin e një audience të synuar dhe në media, gjë që mund të kontribuojë në arritjen e një audiencë më të gjerë. Shembuj të kësaj janë përfshirja e një ekipi të futbollit të ligës më

---

<sup>35</sup> Projekt nën patronatin e Ministrisë së Jashtme Italiane; për më shumë detaje shih <http://feriteamorte.it/eng/blessed-to-death/>.

të lartë në Turqi<sup>36</sup> dhe të një ekipi të ragbit në Gjeorgji<sup>37</sup> për ta tërhequr vëmendjen e burrave dhe djemve. Kur synoni adoleshentët, përfshirja e këngëtarëve pop ose aktorëve të njohur si zëdhënës mund të jetë mënyrë efektive për t'i arritur ata.

Parlamentarët dhe përfaqësuesit e lartë të qeverisë gjithashtu mund të luajnë rol të rëndësishëm në përhapjen e mesazhit në elektoratin e tyre, te kolegët e tyre, etj. Ekspertët, siç janë hulumtuesit ose praktikuesit mund të jenë bartësit më të mirë të porosive për audienca të tjera.

Përdorimi i tregimeve dhe dëshmime individuale të njerëzve të prekur nga dhuna (viktima, autorë të dhunës, anëtarë të familjes dhe të tjerë) mund të jetë një mënyrë e fuqishme për ta përcjellë një mesazh. Megjithatë, kur vendoset të punohet me dëshmitë nga viktimat ose që kanë të bëjnë me to, është e rëndësishme që aspektet etike të merren në konsideratë si prioritet (shih më lart).

## Zgjedhja e vendit dhe kohës së duhur

Ditët ndërkombëtare ose kombëtare, si dhe nxjerrja e raporteve që japin të dhëna të reja janë vërtetuar se janë "nxitës" efektiv kur synohet mbulimi i mediave ose për të tërheq interesimin për një ngjarje sensibilizuese.<sup>38</sup>

Për të rritur vetëdijesimin mes grupeve të specifikuar profesionale dhe të politikëbërësve, takimet me pjesëmarrës të specializuar, si diskutime të paneleve të ekspertëve, konferenca, etj., mund të rezultojnë më efektivet.

Viteve të fundit, komunikimi në internet dhe media sociale kanë luajtur rol në rritje për marketingun komercial dhe social, në veçanti për audienca më të reja. Kur konsiderohet përdorimi i mediave të reja dhe sociale për vetëdijesim, duhet të theksohet se aktualisht ekziston një bazë e kufizuar e provave të rezultateve dhe ndikimit.

---

<sup>36</sup> UNFPA (2007), op. cit. (Studim i rastit në Turqi: fq. 57 f.)

<sup>37</sup> UN Women Georgia (2011), op. cit.

<sup>38</sup> Ditët ndërkombëtare shpesh përdoren për të filluar fushata ose ngjarje: Dita Ndërkombëtare e Gruas (8 marsi), Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas (25 nëntori) dhe Dita e të Drejtave të Njeriut (10 dhjetori - periudha midis këtyre dy ditëve shënon "16 ditët e aktiviteteve ndërkombëtare kundër dhunës gjinore"), Dita e Tolerancës Zero për Gjyftimin e Gjenitaleve të Femrave (6 shkurti), Dita e Shën Valentinit /Dita-V (14 shkurti).

## Mediat (sociale): pjesë e problemit apo pjesë e zgjidhjes?

Kur të merret në konsideratë dobia e mediave (sociale) për vetëdijesim, duhet të jemi të vetëdijshëm se mediat mund të luajnë rol të rëndësishëm në përjetësimin e miteve, stereotipeve dhe përhapjen e përmbajtjeve seksiste dhe të dhunshme ose qëndrimeve që e lejojnë dhunën. Kjo po ashtu mund të jetë hapësirë ku gratë dhe vajzat bëhen caqe të formave të reja të dhunës, siç janë përndjekjet në internet. Kur të shqyrtohet përdorimi i mediave (të reja) në vetëdijesim, këta faktorë duhet të adresohen.<sup>39</sup> Mediat duhet të bëhen "pjesë e zgjidhjes", e jo "pjesë e problemit".

Vetëdijesimi i profesionistëve të mediave për të gjitha format e dhunës ndaj grave është kyç, dhe mund të ketë efekt të gjerë ndikimi. Të siguruarit e mbuueshmërisë editoriale të përmirësuar dhe të saktë të formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe rritja e vetëdijes së profesionistëve të mediave për nevojën për të shmangur imazhet dhe mesazhet që përjetësojnë mitet ose që e pranojnë dhunën ndaj grave, mund të jetë më efektiv për të rritur vetëdijesimin mes një audiencë më të gjerë sesa sigurimi i hapësirës reklamuese në mediat kryesore. Në Turqi, një partneritet i suksesshëm me federatën kombëtare të gazetarëve ka krijuar mundësi për trajnimin e gazetarëve mbi dhunën ndaj grave dhe ka inkurajuar mbulimin e përmirësuar të mediave për këtë çështje përmes një çmimi të ri për gazetarë.<sup>40</sup> Udhëzues për raportimin e përgjegjshëm të mediave mbi dhunën ndaj grave, siç është ai i prodhuar nga Zero Tolerance,<sup>41</sup> DART Center Europe<sup>42</sup> dhe Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve<sup>43</sup> gjithashtu mund të luajnë rol të rëndësishëm në rritjen e vetëdijesimit të gazetarëve. Nga ana tjetër, mediat, përmes raportimit më të mirë, përfshirë përdorimin e saktë të terminologjisë dhe

---

<sup>39</sup> Shih një diskutim të sfidave dhe mundësive të krijuara nga mediat e reja sociale në Këshillin e Evropës (2013), *Mediat dhe imazhi i grave*, Raport i Konferencës së Parë të Rrjetit të Këshillit të Evropës të Pikave Kontaktuese Kombëtare për Barazinë Gjinore, Amsterdam, 4-5 korrik 2013. Këshilli i Evropës, Strasburg, sidomos fq. 9-10

<sup>40</sup> Shih kutinë "Fushatë për ndaljen e dhunës ndaj gruas në Turqi", fq. 12 më lart dhe UNFPA (2006), op. cit.

<sup>41</sup> Zero Tolerance, *Trajtimi me kujdes: udhëzues për raportimin e përgjegjshëm të mediave mbi dhunën ndaj grave*, gjendet në [www.zerotolerance.org.uk/sites/all/files/HWC\\_V5\(1\).pdf](http://www.zerotolerance.org.uk/sites/all/files/HWC_V5(1).pdf)

<sup>42</sup> DART Center Europe (2011), *Raportimi mbi dhunën seksuale. Fletë udhëzimesh nga tip DART Center*, gjendet në [http://dartcenter.org/files/sexual%20violence%20tipsheet\\_fnal\\_27.08.11.pdf](http://dartcenter.org/files/sexual%20violence%20tipsheet_fnal_27.08.11.pdf)

<sup>43</sup> Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (2009), "Udhëzime për raportimin e dhunës ndaj grave", gjendet në <http://ethicaljournalisminitiative.org/en/contents/ifj-guidelines-for-reporting-on-violence-against-women>

shmangien e "termave zbkurues, magjepsës, errësues ose relativizues" për të përshkruar forma të ndryshme të dhunës ndaj grave,<sup>44</sup> por edhe duke u dhënë hapësirë organizatave dhe individëve që sfidojnë dhunën ndaj grave, mund të ndikojnë në vetëdijesim më të lartë të audiencës së tyre. Kjo është arsyeja pse neni 17 i Konventës së Stambollit u bën thirrje shteteve palë që të inkurajojnë mediat të luajnë rol aktiv në parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave.

---

<sup>44</sup> Shih rekomandimet për organizatat e mediave për përdorimin e terminologjisë së duhur kur raportohet për forma të ndryshme të dhunës ndaj grave në Këshillin e Evropës (2013), *Mediat dhe imazhi i grave*, op. cit., veçanërisht fq. 21, gjendet në <http://www.womenlobby.org/news/new-resources/article/council-of-europe-media-and-the?lang=en>.

## Konkludimi

---

**V**etëdijesimi i shtuar dhe të kuptuarit e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe ndikimit të tyre tek fëmijët janë një parakusht për ndryshime në qëndrime dhe sjellje. Prandaj dhe mund të luajë rol të rëndësishëm si pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse të parandalimit. Për të qenë efikas, është e rëndësishme të sigurohet që fushatat ose programet e vetëdijesimit të dizajnohen si pjesë përbërëse e një qasjeje gjithëpërfshirëse e të qëndrueshme për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave, siç mund të jetë një plan veprimi ose program kombëtar dhe duhet të ndahet buxheti i duhur për to. Një kornizë e qartë, e cila përkufizon objektiva të qarta, caqet dhe mënyrat për të matur dhe vlerësuar suksesin, është po aq e rëndësishme sa zgjedhja e partnerëve, siç është shoqëria civile dhe partnerët e tjerë me përvojë përkatëse - në veçanti OJQ-të e specializuara për ti dhënë fund dhunës ndaj grave.

Mbështetur në njohuritë dhe ekspertizën ekzistuese dhe duke marrë parasysh natyrën reciproke përforcuese dhe të ndërthurur të detyrimeve shtesë të konventës në fushën e parandalimit, është e mundur të hartohen nisma efikase të vetëdijesimit, të përshtatshme për kontekste të ndryshme lokale ose kombëtare.



# Lista kontrolluese për fushatat e vetëdijesimit

---

**F**ushatat vetëdijesuese mund të inicohen nga një mori akterësh, individualisht ose në partneritet, duke filluar nga institucionet e qeverisë në të gjitha nivelet (lokale, rajonale, kombëtare) deri te organizatat joqeveritare dhe të shoqërisë civile. Për herë të parë, neni 13 i Konventës së Stambollit parasheh një detyrim ligjor për shtetet palë, d.m.th. qeveritë, që rregullisht të ndërmarrin nisma të vetëdijesimit. Lista e mëposhtme kontrolluese mund të ndihmojë në dizajnimin dhe zbatimin e çfarëdo fushate apo mase vetëdijesimi:

- A është fushata e bazuar në një përkufizim dhe të kuptuar të qartë të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në aspekt të të drejtave gjinore dhe të njeriut (p.sh. a i shqyrton dhe adreson çështjet themelore, siç janë pabarazia gjinore dhe diskriminimi, normat që tolerojnë dhunën dhe stereotipet e dëmshme gjinore, etj.)?
- A është fushata pjesë integrale e një qasjeje gjithëpërfshirëse për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave, si ndonjë plani veprimi kombëtar ose program dhe a është planifikuar si një nismë e qëndrueshme afatgjate?
- A është fushata e bazuar në një model logjik, me objektiva dhe synime të qarta, tregues për të matur rezultatet, dhe a përmban një kornizë monitorimi dhe vlerësimi?
- A është fushata e bazuar në hulumtime dhe të dhëna/njohuri:
  - si funksionon vetëdijesimi (d.m.th a është realiste në lidhje me atë që mund dhe nuk mund të arrijë);
  - për temën;
  - grupin e synuar;
  - llojin më të mirë të mesazheve për të arritur tek grupi i synuar ("Çfarë duhet të dëgjojnë?");
  - mënyrën më të mirë për të arritur tek grupi i synuar ("Si t'i bëjmë që ta dëgjojnë?")?

- Në rast se të dhënat nuk janë në dispozicion, a parashikon projekti për të filluar një aktivitet vetëdijesimi për kryerjen e ndonjë hulumtimi për të identifikuar çështjet e mësipërme (tema, grupi i synuar, mënyra më e mirë për t'i arritur ata, etj.)?
- A është ndarë buxhet i duhur për të zbatuar aktivitetet që janë të nevojshme për të arritur objektivat e fushatës (përfshirë monitorimin dhe vlerësimin)?
- A janë përfshirë ekspertë të specializuar në fushën e dhunës ndaj grave në fazën e planifikimit (në veçanti organizatat e grave, përfshirë ato që punojnë me viktimat), si dhe ekspertë për komunikim?
- A e përcakton fushata temën specifike ose formën e dhunës ndaj grave që synon ta trajtojë (duke u siguruar që në planin afatgjatë të adresohen të gjitha format e dhunës ndaj grave, dhe pasojave për fëmijët)?
- A është fushata e përshtatur për kontekstin kombëtar/rajonar/lokal?
- A është zgjedhur një audiencë e caktuar specifike: gra në rrezik ose veçse të prekura nga dhuna, spektatorët, autorët, grupet e moshave të ndryshme, grupet e ndryshme profesionale (duke siguruar që në planin afatgjatë të arrihen të gjithë anëtarët e shoqërisë)?
- A janë mjetet dhe mediat e zgjedhura, si dhe koha dhe vendi, të përshtatshme për ta arritur audiencën e synuar?
- A përfshin fushata sugjerime për veprime/vazhdimet/ndryshime konkrete për grupin e synuar?
- A janë marrë parasysh çështjet etike, d.m.th. a u është kushtuar vëmendje mesazheve dhe imazheve të transmetuara (siç janë mënjanimi i stereotipizimit të grave si viktimave pasive dhe burrave si autorë, dërgimi i mesazheve pozitive dhe fuqizuese)?
- A janë konsultuar rekomandimet, udhëzimet dhe listat kontrolluese për "çka mund e çka nuk mund të bëhet" për komunikimin në lidhje me dhunën ndaj grave?
- A janë konsideruar mjetet kreative, novatore për ta përcjellë mesazhin e fushatës?
- A është konsideruar përdorimi i personaliteteve model dhe i "ambasadorëve", pasi ata duken të jenë efektivë në adresimin e grupeve të veçanta?
- A është vlerësuar me kujdes se si të përfshihen mediat dhe nëse më parë do duhej vetëdijesimi i vendimmarrësve të mediave dhe gazetarëve?

# Burimet kryesore

---

## Fushatat dhe iniciativat e vetëdijesimit në Evropë

---

**N**ë internet mund të gjenden një varg shembujsh frymëzues të fushatave mbi aspekte të ndryshme të dhunës ndaj grave të iniciuara dhe zbatuara nga qeveritë dhe OJQ-të në Evropë. Kjo nuk është një përmbledhje gjithëpërfshirëse e qasjeve ekzistuese që janë ndërmarrë për të rritur vetëdijesimin për dhunën ndaj grave në Evropë.

### 1. Këshilli i Evropës

Fushata për të luftuar dhunën ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, 2006-2008, Raporti përfundimtar i aktivitetit<sup>45</sup>

### 2. Lobi i Grave Evropiane

Grumbullimi i posterëve dhe videoklipeve "Vetëdijesimi për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave: fushata të suksesshme"<sup>46</sup>.

Ky është një koleksion i posterëve dhe videoklipeve mbi disa forma të dhunës ndaj grave, përfshirë përdhunimin, dhunën në familje, trafikimin, vrasjet e nderit, prostitucionin, gjymtimin e organeve gjenitale të femrave, ngacmimin në rrugë dhe martesën e detyruar. Megjithatë, nuk ka kritere për mënyrën se si suksesi i tyre është matur ose vlerësuar.

Vepro kundër përdhunimit! Përdoreni Konventën e Stambollit!

Një projekt i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Lobit të Grave Evropiane në vitin 2013 rezultoi me një varg materiale që mund të përdoren në fushatat e ardhshme kundër përdhunimit, sidomos si pjesë e pakos së veprimeve.

---

<sup>45</sup> Shih

[www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/fnal\\_Activity\\_report.pdf](http://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/fnal_Activity_report.pdf).

<sup>46</sup> Shih [www.womenlobby.org/Get-involved/EWL-Campaigns/a-european-year-to-end-violence/raising-awareness-to-end-violence/?lang=en](http://www.womenlobby.org/Get-involved/EWL-Campaigns/a-european-year-to-end-violence/raising-awareness-to-end-violence/?lang=en).

### 3. Komisioni Evropian

Komisioni Evropian (2012), *Shkëmbim i praktikave të mira mbi barazinë gjinore: Aktivitete vetëdijesuese për ta luftuar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Raport përmbledhës*, Komisioni Evropian (DG Drejtësi), MB<sup>47</sup>

### 4. Instituti Evropian për Barazi Gjinore

Fushata vetëdijesuese kundër dhunës seksuale nga qeveritë dhe OJQ-të<sup>48</sup>.

Një studim mbi dhunën seksuale ndaj grave në BE rezultoi me një bazë të dhënash e cila përfshin informacione nga qeveritë dhe OJQ-të mbi fushatat e vetëdijesimit kundër dhunës seksuale.

“Metodat dhe mjetet për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje”<sup>49</sup>

Kjo është një bazë e të dhënave për aktivitetet e vetëdijesimit të ndërmarra nga qeveritë dhe OJQ-të.

“Metodat dhe mjetet për gjymtimin gjenital të femrave”<sup>50</sup>

Kjo është një bazë e të dhënave për aktivitetet e vetëdijesimit të ndërmarra nga qeveritë dhe OJQ-të.

### 5. Komiteti Këshillimor për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat

Opinion për një fushatë të mundshme vetëdijesimi të BE-së për dhunën ndaj grave dhe vajzave<sup>51</sup>

Ky dokument përmban një aneks me praktikën e mira në fushatat e vetëdijesimit në vendet anëtare të BE-së.. Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave (UN WOMEN)

Qendra e Njohurive Virtuale e Grave të Kombeve të Bashkuara për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave, Vështrim i përgjithshëm mbi fushatat<sup>52</sup>

Ky koleksion përfshin disa fushata në vendet anëtare të Këshillit të Evropës.

---

<sup>47</sup> Shih [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/other-institutions/good-practices/review-seminars/seminars\\_2012/violence\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/other-institutions/good-practices/review-seminars/seminars_2012/violence_en.htm).

<sup>48</sup> Shih <http://eige.europa.eu/content/sexual-violence>.

<sup>49</sup> Shih <http://eige.europa.eu/methods-and-tools/domestic-violence?title=&foc%5B%5D=697>.

<sup>50</sup> Shih <http://eige.europa.eu/methods-and-tools/female-genital-mutilation?title=&cat%5B%5D=570>.

<sup>51</sup> Shih [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/fles/opinions\\_advisory\\_committee/opinion\\_on\\_a\\_possible\\_eu\\_awareness\\_raising\\_campaign\\_on\\_violence\\_against\\_women\\_and\\_girls\\_\(vawg\)\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/fles/opinions_advisory_committee/opinion_on_a_possible_eu_awareness_raising_campaign_on_violence_against_women_and_girls_(vawg)_en.pdf).

<sup>52</sup> Shih [www.endvawnow.org/sq/articles/158-campaigns.html](http://www.endvawnow.org/sq/articles/158-campaigns.html).

## **Udhëzime për komunikimin mbi dhunën ndaj grave**

---

UNIFEM (2001): *Përfytyrimi i një jete pa dhunë: strategjitë e komunikimit medial për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave*<sup>53</sup>

Ky koleksion gjendet në internet në anglisht dhe spanjisht dhe përfshin disa shembuj nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës.

UNIFEM (2003): *Bërja e ndryshimit: komunikimet strategjike për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave*<sup>54</sup> (gjendet në anglisht dhe rusisht)

Tolerancë zero: Trajtoni me kujdes: Udhëzues për raportim të përgjegjshëm medial të dhunës ndaj grave<sup>55</sup>

DART Centre Europe (2011): Raportimi i dhunës seksuale: Udhëzues nga Dart Center Europe<sup>56</sup>

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (2008): Udhëzime për raportimin e dhunës ndaj grave<sup>57</sup>

COSC (2013): Dokument i komunikimit për qasjet e përdorura për promovimin dhe zhvillimin e të kuptuarit të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe me bazë gjinore<sup>58</sup>

Zyra Qeveritare për Barazi (2009): "Luftimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave: Udhëzues për komunikimin e praktikave të mira",<sup>59</sup> Londër

---

<sup>53</sup> Shih [www.endvawnow.org/en/tools/view/431-picturing-a-life-free-of-violence-media-communication-strategies-to-end-violence-against-women-2001.html](http://www.endvawnow.org/en/tools/view/431-picturing-a-life-free-of-violence-media-communication-strategies-to-end-violence-against-women-2001.html).

<sup>54</sup> Shih [www.endvawnow.org/en/tools/view/342-making-a-diference-strategic-communications-to-end-violence-against-women-2003.html](http://www.endvawnow.org/en/tools/view/342-making-a-diference-strategic-communications-to-end-violence-against-women-2003.html).

<sup>55</sup> Shih [www.zerotolerance.org.uk/sites/all/files/files/HWC\\_V5\(1\).pdf](http://www.zerotolerance.org.uk/sites/all/files/files/HWC_V5(1).pdf)

<sup>56</sup> Shih [http://dartcenter.org/files/sexual%20violence%20tipsheet\\_fnal\\_27.08.11.pdf](http://dartcenter.org/files/sexual%20violence%20tipsheet_fnal_27.08.11.pdf)

<sup>57</sup> Shih <http://ethicaljournalisminitiative.org/en/contents/if-guidlines-for-reporting-on-violence-against-women>.

<sup>58</sup> Shih

[www.cosc.ie/en/COSC/Communications%20paper%202013.pdf/Files/Communications%20aper%202013.pdf](http://www.cosc.ie/en/COSC/Communications%20paper%202013.pdf/Files/Communications%20aper%202013.pdf).

<sup>59</sup> Shih [http://sta.geo.useconnect.co.uk/news/vaw\\_guidance.aspx](http://sta.geo.useconnect.co.uk/news/vaw_guidance.aspx).

# Bibliografia

---

Brooks O. (2011), "Djema! Ndaleni! Pranimi dhe refuzimi i këshillave të sigurisë nga gratë kur shoqërohen në bare, kafene dhe klube", *British Journal of Criminology*, vëllimi 51, edicioni 4, faqe 635-651.

Cerise S. (2011), "Një botë e ndryshme është e mundur: një thirrje për veprim afatgjatë dhe të synuar për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave", Koalicioni për Eliminim të Dhunës ndaj Grave (EVAW), Londër

COSC (2013), "Dokument komunikimi për qasjet në promovimin dhe zhvillimin e të kuptuarit të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe gjinore", Zyra Kombëtare për Parandalimin e Dhunës në Familje, Seksuale dhe Gjinore (COSC), Dublin

COSC, "Parimet udhëzuese për aktivitetet e vetëdijesimit të publikut në lidhje me dhunën në familje, seksuale dhe me bazë gjinore", Zyra Kombëtare për Parandalimin e Dhunës në Familje, Seksuale dhe Bazuar Gjinore (COSC), Dublin

Këshilli i Evropës (2008), "Taskforca për luftimin e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje (EG-TFV)", Këshilli i Evropës, Strasburg

Këshilli i Evropës (2011), "Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe raporti shpjegues", Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg

Këshilli i Evropës (2013), *Mediat dhe imazhi i grave*, Raport i Konferencës së Parë të Rrjetit të Këshillit të Evropës të Pikave Kontaktuese Kombëtare për Barazinë Gjinore, Amsterdam, 4-5 korrik 2013

Këshilli i Evropës (2014), "Studim analitik i rezultateve të rrethit të katërt të monitorimit të zbatimit të Rekomandimit Rec(2002)5 për mbrojtjen e grave kundër dhunës në vendet anëtare të Këshillit të Evropës", përgatitur nga Prof. Dr. Carol Hagemann-White, Publikim nga Këshilli i Evropës, Strasburg.

DART Center Europe (2011), "Raportimi mbi dhunën seksuale", udhëzues nga DART Centre Europe, gjendet në [http://dartcenter.org/fles/sexual%20violence%20tipsheet\\_fnal\\_27.08.11.pdf](http://dartcenter.org/fles/sexual%20violence%20tipsheet_fnal_27.08.11.pdf)

Komisioni Evropian (2012), *Shkëmbim i praktikave të mira mbi barazinë gjinore: aktivitete sensibilizuese për luftimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Raport përmbledhës*, Komisioni Evropian (Drejtësi), MB

Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Komunikim (2010), *Eurobarometer 73.2: Dhuna në familje ndaj grave*, TNS Opinion & Social, Bruksel

Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian X për Informim, Komunikim, Kulturë dhe Media Audiovizuale (1999), *Eurobarometer 51.0: Evropianët dhe pikëpamjet e tyre mbi dhunën në familje ndaj grave*, Bruksel

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (2014), *Dhuna ndaj grave: një studim në gjithë BE-në. Rezultatet kryesore*, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg

Zyra Qeveritare për Barazi (2009), *Luftimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave. Udhëzues për komunikimet e praktikave të mira*, Londër

Hagemann-White C. et al. (2010), *Faktorët që ndikojnë në ushtrimin e dhunës ndaj grave, dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës ndaj orientimit seksual - Një model interaktiv me shumë nivele* (pjesë e studimit të fizibilitetit për të vlerësuar mundësitë, shanset dhe nevojat për të standardizuar legjislacionin kombëtar për dhunën gjinore dhe dhunën ndaj fëmijëve për Komisionin Evropian- JLS/2009/D4/018), Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg

Heise LL (1998), "Dhuna ndaj grave: kornizë e integruar, ekologjike", *Dhuna ndaj Grave*, vëll. 4, nr. 3, faqe 262-290.

Hester M. dhe Lilley S.-J. (2014), *Parandalimi i dhunës ndaj grave: Neni 12 i Konventës së Stambollit*, Botim i Këshillit të Evropës, Strasburg

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (2009), "Udhëzimet e IJF për raportimin e dhunës ndaj grave" në *Gjetja e baraspeshës së duhur: barazia gjinore në gazetari*, IFJ, Bruksel

Kitzinger J. (1994), "Sfidimi i dhunës seksuale ndaj vajzave: një qasje e vetëdijes shoqërore", *Rishikimi i Abuzimit të Fëmijëve*, vëll. 3, Nr. 4, faqe 246-248

OSBE (2009), *Sjellja e sigurisë në shtëpi: luftimi i dhunës ndaj grave në rajonin e OSBE-së. Një përmbledhje e praktikave të mira*, Seksioni Gjinor, Sekretariati i OSBE-së, Vjenë

UNFPA (2007), *Programimi i adresimit të dhunës ndaj grave. 10 raste studimore*, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, Nju Jork. gjendet në [www.unfpa.org/public/global/pid/386](http://www.unfpa.org/public/global/pid/386)

UNIFEM (2001), *Përfytyrimi i një jetë pa dhunë: strategjitë mediale dhe të komunikimit për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave*, gjenden në internet në anglisht dhe spanjisht në:

[www.endvawnow.org/uploads/browser/files/Picturing%20a%20Life%20Free%20of%20Violence%20English.pdf](http://www.endvawnow.org/uploads/browser/files/Picturing%20a%20Life%20Free%20of%20Violence%20English.pdf)

UNIFEM (2003), *Duke bërë ndryshim: komunikimet strategjike për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave*, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave, Nju Jork, gjendet në

[www.endvawnow.org/en/tools/view/342-making-a-diference-strategic-communications- to-end-violence-against-women-2003.html](http://www.endvawnow.org/en/tools/view/342-making-a-diference-strategic-communications- to-end-violence-against-women-2003.html)

UN Women (2011), "Raporti përfundimtar i vlerësimit: Përmirësimi i Parandalimit dhe Reagimit ndaj Dhunës në Familje në Gjeorgji – ShiEld", gjendet në [www.endvawnow.org/uploads/browser/files/shield\\_communications\\_report\\_fnal\\_fnal.pdf](http://www.endvawnow.org/uploads/browser/files/shield_communications_report_fnal_fnal.pdf)

Qendra e Njohurive Virtuale e Grave të KB për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave (2012), *Fushatat për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave*, UN Women, *gjenden në www.endvawnow.org, nën modulet e Programimit; fushatat*

OBSH(2009), "Parandalimi i dhunës: provat. Promovimi i barazisë gjinore për të parandaluar dhunën ndaj grave (Përmbledhje informuese rreth dhunës), Organizata Botërore e Shëndetësisë

Zero Toleranca, *Trajtimi me kujdes: udhëzues për raportimin e përgjegjshëm të mediave mbi dhunën ndaj grave*, gjendet në [www.zerotolerance.org.uk/sites/all/files/fles/HWC\\_V5\(1\).pdf](http://www.zerotolerance.org.uk/sites/all/files/fles/HWC_V5(1).pdf)